# KONTRATE - THEMELIMI

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerit Tregetare si dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 :

1.- MUHARREM PLLOÇI, i biri i Zenelit dhe i Haves,lindur me 1960 dhe banues ne Burrel.

2.- IKBALE KURTI, e bija e Fehmiut dhe e Xhevahires,lindur me 1927, banuese ne Burrel, me cilesine e ortakeve te Shoqerise ndertimore Lidhim kete kontrate :

NENI 1

Te veprojne si ortak te Shqqerise Ndertimore " SIGER'S " Sh.P.K.me seli ne Burrel,me kapital themeltar 100.000 leke per nje afat mbi 10 vjet me te drejte perseritje.

NENI 2

Kontributi ne Kapitalin themeltar eshte :

1.- Muharremm Plloçi 50.000 leke

2.- Ikbale Kurti 50.000 leke

Ne kete mase do te jene edhe perfitimi nga te ardhurat apo mbulimi nga humbjet.

NENI 3

Veprimtaria e tyre do te jete ne fushen qe eshte percaktuar ne objektin e veprimtarise se Shoqerise ne Statutin e saj.

NENI 4

Te drejtat dhe detyrat e sejcilit ortak do te jene te percaktuara ne statutin e shoqerise.

NENI 5

Muharrem Plloçi dhe Ikbale Kurti jane bashkepronar te shoqerise ndertimore " SIGER'S " Sh.P.K.

NENI 6

Sejcili ortak para se te heq dore nga pjesemarrja e tij ne kete shoqeri,duhet te njoftoje ortakun tjeter ne afatin e parashikuar ne ligj.

NENI 7

Sejcili ortak ka te drejte qe pjesen e fitimit te realizuar ne

masen qe eshte edhe kontributi i tij me kapitalin fillestar themelues,ta transferoje edhe jashte shtetit.

N E N I 8

Sejcili prej ortakeve,nuk mund te ndaloje tjetrin qe te heq dore nga pjesmarrja ne shoqeri. N.q.s largohet nga shoqeria, kuoten e tij ja shet ortakut tjeter,ose te treteve kur nuk blihet nga ortaku tjeter,siç parashikohet ne statu

N E N I 9

Sejcili ortak eshte i detyruar te zbatoje nenet e kontrates dhe te statutit te shoqerise,te legjislacionit Shqiptar ne pergjithesi dhe atij te ndertimit e tregetar ne veçanti.

N E N I 10

Mosmarveshjet qe mund te lindin do te zgjidhen me mirekuptim, ose me rruge gjyqesore ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

N E N I 11

Kjo kontrate u redaktua konforme vullnetit te lire dhe te plote te ortaketve dhe nenshkruhet rregullisht prej tyre.

ORTAKET THEMELUES :

1.- MUHARREM PLLOÇI 2.- IKBALE KURTI

# S T A T U T I

# I

# SHOQERISE NDERTIMORE " SIGER'S " SHPK.

Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 : 1.- MUHARREM PLLOÇI

2.- IKBALE KURTI

Themelues te Shoqerise Ndertimore " SIGER'S " ShPK hartuan Statutin e saj me keto nene :

## T H E M E L I M I

### N E N I 1

Themelimi i Shoqerise "SIGER'S " ShPK me ortak Muharrem Plloçin e Ikbale Kurti.

### N E N I 2

Selia e shoqerise "SIGER'S" SHPK eshte ne lagjen "Drita Burrel.Por me zgjerimin e aktivitetit ajo mund te çel edhe qendra te tjera ne disa rrethe te tjera,ne te gjithe teritorin e Shqiperise.

### N E N I 3

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ekonimik per nje perjudhe te pakufizuar,mbi 10 vjet.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### N E N I 4

Shoqeria "SIGER'S " ShPK do te ushtroje aktivitetin e saj privat ne fushen e ndertimit,per projktim e zbatim ne disa zera si :

- Punime dheu,murature,betoni,b/arme te zakonshme,punime shembjesh.
- Ndertime civile,industriale,bujqesore etj.,kompletimi me instalimet e nevojshme ne to.
- Punime restaurimi.

### N E N I 5

Shoqeria mund te ndyrshoje emertimin,Seline ose objektin e veprimtarise se saj vetem me vendim te keshillit drejtues.

## K A P I T A L I

### N E N I 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i formuar ne kete menyre : MUHARREM PLLOÇI 50.000 leke

Ikbale Kurti 50.000 leke

%

N E N I 7

Kapitali themeltar mund te shtohet me vendim te keshillit drejtues.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

N E N I 8

Organi vendimor i shoqerise eshte Keshilli Drejtues,ku marrin pjese te dy ortaket me vota te barabarta.

Ne Keshillim Drejtues vendoset per ndryshimet,per shtimin e Kapitalit themeltar,per shtimin ose paksimin e numrit te ortakeve,per emrimin e administratorit,per pushimin e veprimtarise se shoqerise etj.

Unanimiteti ne vendimet e Keshillit Drejtues eshte i domosdoshem :

- Per ndryshime ne Statut dhe ne Kontraten e Shoqerise.
- Per rritjen e Kapitalit
- Per kohezgjatjen e veprimtarise se shoqerise.
- Per pushimin e veprimtarise para afatit te percaktuar ne statut.
- Per çeshtje te tjera Keshilli Drejtues vendos me shumice votash.

N E N I 9

Vendimet e marra nga Keshilli Drejtues jane te detyrueshme edhe per ortakum qe ka votuar kundra.

N E N I 10

Vendimet e marra nga Keshilli Drejtues evidentohen ne proçes-verbal, i cili nenshkruhet nga te dy ortaket.

TE DREJTAT DHE DETYRAT

N E N I 11

Ortaket gezojne keto te drejta :

- Marin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise
- Marrin pjese ne rezultatet e shoqerise,ne çdo forme dhe ne çdo sasi, sipas kontributit ne kapitalin fillestar themeltar.
- Njihen me te dhenat per gjendjen ekonomike-finaciare te shoqerise si dhe me çdo dokument ku evidentohet veprimtaria e shoqerise.

N E N I 12

Ortaket kane edhe keto detyrime :

- Te depozitojne kuotem per formimin e kapitalit baze.
- Te jap te dhenat e domosdoshme ekonomiko-finaciare dhe çdo dokument që ka te beje me mbarvajtjen e veprimtarise se shoqerise.
- Te kryej detyrat e ngarkuara nga Keshilli Drejtues dhe Administrator ri.

N E N I 13

Sejcili ortak ka te drejte qe te heq dore nga shoqeria,duke qene i detyruar qe te njoftoje ortakun tjeter ne afatin e parashikuar me ligj.

Heqja dore e ortakut nuk e shkarkon ate nga detyrimet e marra ndaj shoqerise dhe nuk pengon detyrimet e shoqerise,ndaj ortakut qe largohet.

N E N I 14

Drejtuese teknike e shoqerise do te jete z.IKBALE KURTI.

Ndasa Drejtor Administrativ i shoqerise "SIGER'S " SHPK do te jete z.MUHARREM PLLOÇI.

N E N I 15

Shoqeria " SIGER'S " ShPK vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime.

N E N I 16

Shoqeria "SIGER'S" ShPK eshte prone e ortakeve Muharrem Plloci e Ikb le Kurti.

N E N I 17

Shoqeria mund te çel llogari te saj ne lek ose ne valut,ne Bankat Sh tare apo te huaja,brenda ose jashte shtetit.

Ajo mund te marre kredi nga Bankat Shqiptare apo te huaja,private o shteterore.

N E N I 18

Shoqeria ka te drejten e tjetersimit dhe te perdorimit te pasurive te veta ne perputhje me qellimet e veprimtarise qe kryen, e sipas ligjeve fuqi.

N E N I 19

PERFAQESIMI

Perfaqesimi i shoqerise i perket Drejtorit administrativ.

MARDHENIET E PUNES

N E N I 20

Mardheniet e punes me te punesuarit ne kete shoqeri rregullohen sipas ligjeve ne fuqi dhe sipas kontrates se punes te lidhur me ta ku percaktohet koha dhe paga e tyre.

Paga percaktohet nga Drejtori administrativ, ose Keshilli Drejtues, ne perputhje me treguesit ekonomoko-financiar te shoqerise.

N E N I 21

Shoqeria mund te punesoje persona fizik dhe specialist te ndryshem shqiptar ose te huaj

N E N I 22

Shoqeria mund te bashkepunoje dhe te lidh kontrata te ndryshme pune edhe me shoqeri te tjera private ose shteterore.

N E N I 23

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJEVE NE PUNE

Mos marveshjet e ndryshme qe mund te lindin do te zgjidhen me mirekuptim,ose kur nuk arrihet ai ne rruge Gjyqesore ne Gjykaten e rrethit Tirane.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

N E N I 24

Veprimtaria financiare e shoqerise mbeshtetet ne fitim humbjet e shprehur ne valute te konvertushme.

Rezultatet financiare te shoqerise,caktohen ne baze te bilancit vjetor.

N E N I 25

Veprimet financiare te shoqerise fillojene me 1 Janar dhe mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti, perveçse ndryshe sipas vendimit te Keshillit Drejtues.

N E N I 26

Ne fund te perjudhes ushtrimore nxirret bilanci kontabel i shoqerise me fitim, humbje, bazuar ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit, qe kerkohen nga organet kopetente.

Bilanc i miratohet nga Keshilli Drejtues.

N E N I 27

Pas veçimit te fondit te akumulimit,te pageses se punonjesve, te

detyrimeve fiskale e te sigurimeve te ndryshme,te ardhurat neto,fitimi ndah midis ortakeve sipas kontributit te sejcilit ne krijimin e kapitalit themel tare.

Keshilli Drejtues mund te vendose,per perdorimin e te ardhurave neto te krijuara, per shtimin e veprimtarise se shoqerise ose te paksoje apo te pushoje veprimtarine e saj kur bilanci rezultom me humbje, por per kete duke vene ne dijeni te gjithe te punesuarit ne te ,sipas afatit te percaktuar ne ligj.

SHPERBERJA

N E N I 28

Shkaqet per shperberjen e shoqerise mund te jene te ndryshme dhe ato mund te vine ne çdo kohe.

N E N I 29

Keshilli Drejtues vendos mbi menyren e shperberjes, duke likujduar me pare detyrimet ndaj te treteve.

N E N I 30

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut shoqerie i referohet legjislacionit Shqiptar ne pergjithesi dhe atij ne fushen e nderitmit e te tregetis ne veçanti.

N E N I 31

Statuti nenshkruhet prej ortakeve themelues te Shoqerise "SIGER'S " ShPK :

1.- MUHARREM PLLOÇI 2.- IKBALE KURTI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTESISE

- N O T E R I A -

Nr. 2804 Rep.

Nr. 1902 Kol.

MIMOZA SHEHU NOTERE TIRANA ALBANIA

V E R T E T I M

Sot me daten 2 Dhjetor 1994(nentedhjet e kater) u paraqiten personalisht : MUHARREM PLLOÇI e IKBALE KURTI,madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar me identitetin e mesiperm per te cilin u sigurova edhe nga leternjoftimet e tyre personale, te cilet deklaruan se sa siper eshte Statuti i Shoqerise " SIGER'S " SHPK,ku ato jane ortak, i hartuar me vullnetin e tyre te lire jash te kesaj zyre dhe une Noteria pasi e gjej te rregul... ...je sipas ligjit

Mimoza Shehu